



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

---

Numri i lëndës: 2021:233411  
Datë: 24.12.2024  
Numri i dokumentit: 06644385

Pml.nr.750/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit A. M., nga S., për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë”, e parashikuar me nenin 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të të pandehurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, P.nr.224/2021, datë 03.11.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1659/2023, datë 27.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të të pandehurit A. M., ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, P.nr.224/2021, datë 03.11.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1659/2023, datë 27.05.2024, ashtu që duke u bazuar në nenin 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i pandehuri

LIROHET NGA AKUZA

Sepse kinse më 22.10.2020, rreth orës 02:59 minuta, në rrugën “...”, në S., konkretisht në barnatoren “E. M.”, me dashje, e merr pasurinë e personit tjetër me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo për personin tjetër, ashtu që i pandehuri duke përdorur forcë dhe mjetin e përshtatshëm, ka depërtuar brenda në barnatore, ku në një sirtar të kësaj barnatore ka marrë para në shumën e përafërt prej njëqindpesëdhjetë (150)

euro, ku përveç parave, të dëmtuarit i është shkaktuar edhe dëm në xhamin e barnatores në vlerën e përafërt prej njëqind (100) euro,

- me këtë kishte për të kryer veprën penale “Vjedhja e rëndë”, e parashikuar me nenin 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës

Pala e dëmtuar – E. (F.) K., nga S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, P.nr.224/2021, datë 03.11.2023, i pandehuri A. M., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë”, e parashikuar me nenin 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPRK dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve dhe dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) euro, të cilin shumë është detyruar për ta paguar në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, atëherë dënimi me gjobë, në bazë të nenit 43, paragrafi 3 të KPRK-së, do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që një (1) ditë e dënimit me burgim do të llogaritet me njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë.

Është detyruar i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzetë (20) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Pala e dëmtuar – E. (F.) K., nga S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1659/2023, datë 27.05.2024, e ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë vetëm sa i përket dënimit me burgim të shqiptuar, ndërsa dënimi me gjobë i shqiptuar ka mbetur i pandryshuar, ashtu që ndaj të pandehurit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim është bërë i formës së prerë, kurse në pjesët tjera aktgjykimi në fjalë ka mbetur i pandryshuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i pandehuri A. M., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe nga

përmbajtja e pretendimeve, del që kërkesa është paraqitur edhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që i pandehuri të lirohet nga akuza apo këto aktgjykime të anulohen dhe kjo çështje të kthehet në rigjykim.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.429/2024, datë 05.12.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e bazuar.

I pandehuri përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë bazuar vetëm në deklaratën e tij të dhënë në polici më 11.12.2020, e cila deklaratë është dhënë nën ndikimin e shtrëngimit, mashtrimit dhe premtimit, se nëse pranohet vepra penale, atëherë do të përfundohet ky rast dhe do të lirohet. Aktgjykimet e kundërshtuara nuk kanë mundur që të kenë për bazë vetëm deklaratën e tillë të të pandehurit të dhënë në polici, e cila nuk gjen mbështetje as në ekspertizën e kryer për provat e gishtërinjve dhe as në video incizimin me marrë nga lokali, nga të cilat nuk vërtetohet se personi i cili e ka kryer vjedhjen është i pandehuri në këtë rast. Mbi bazën e këtyre që u theksuan më lart, i pandehuri pretendon se këto aktgjykime janë bazuar në provë të papranueshme, duke ju referuar këtu deklaratës së lartcekur, ndërsa gjykatat nuk e kanë marrë për bazë deklaratën tjetër të dhënë në polici më 22.10.2021 dhe as provat tjera që gjenden në shkresa të lëndës, të cilat sikur të shikoheshin me kujdes do të duhej marrë aktgjykim lirues për të pandehurin dhe se nuk është dashur që të shpallet fajtor, pa pasur asnjë provë bindëse.

Duke i vlerësuar pretendimet e lartcekura të të pandehurit, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të bazuara, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje të ligjit penal nga neni 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së në dëm të të pandehurit A. M., për arsyet që do të paraqiten në vijim.

Nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë rezulton se prova vendimtare mbi bazën e të cilave është bazuar konstatimi i kësaj gjykate në lidhje me fajësinë e të pandehurit është deklarata e të pandehurit e dhënë në polici më 11.12.2020. Nga shkresat e lëndës shihet se kjo deklaratë e të pandehurit, mbi bazën e të cilës është bazuar aktgjykimi në fjalë është marrë pa prezencën e avokatit mbrojtës, por që e njëjta është nënshkruar vetëm nga i pandehuri dhe nga dy (2) zyrtarët policorë: N. Q. dhe F. K., ndërsa një deklaratë e tillë, shihet që është mohuar në vazhdimësi nga i pandehuri, duke pretenduar se e njëjta është marrë me presion dhe premtime, se nëse e pranon veprën penale, do të lirohet dhe do të

përfundon procedura, duke qenë se për të pandehurin kjo ishte hera e parë që ishte marrë në pyetje nga ana e zyrtarëve policorë për ndonjë rast penal. Në anën tjetër, me asnjë provë tjetër që është administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor nuk rezulton që të jetë vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri A. M., është kryes i veprës penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor.

Në këtë rast, nuk është fare kontestuese fakti i kryerjes së veprës penale “Vjedhja e rëndë”, e parashikuar me nenin 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPRK-së, të përshkruar më hollësisht në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, mirëpo kontestuese dhe e pa vërtetuar me prova të pranueshme ka mbetur fakti nëse kryes i kësaj vepre penale është i pandehuri A. M.

Sa i përket deklaratës së të pandehurit të dhënë para zyrtarëve policorë më 11.12.2020, pa prezencën e avokatit mbrojtës, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se kjo deklaratë si e tillë, nuk mund të jetë provë vendimtare, mbi bazën e së cilës, do të mbështetej fajësia e të pandehurit, ndërsa një kufizim i tillë është parashikuar në mënyrë shprehimore në dispozitën ligjore të nenit 257, paragrafi 2 të KPP-së, e cila përcakton se “Gjykata nuk e shpall të pandehurin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaramit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit”. Bazuar në këtë dispozitë ligjore, por edhe në faktin se kjo deklaratë është marrë pa prezencën e avokatit mbrojtës, se një deklaratë e tillë ishte mohuar në tërësi dhe vazhdimësi nga i pandehuri, kurse duke pasur parasysh faktin se me provat tjera nuk është vërtetuar ndërlidhja e të pandehurit me veprën penale për të cilën është akuzuar, atëherë, sipas vlerësimit të Gjykata Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së parë nuk është dashur që të pandehurin ta shpall fajtor vetëm duke u bazuar në këtë deklaratë.

Gjykata Supreme e Kosovës ka parasysh edhe deklaramet e dy (2) zyrtarëve policorë, në cilësi të dëshmitarëve, të cilët e kanë intervistuar të pandehurin, mirëpo të njëjtat nuk janë vlerësuar si të mjaftueshme për të arritur deri tek përfundimi i bazuar se i pandehuri të ketë lidhje me veprën penale për të cilën ishte dyshuar, akuzuar dhe shpallur fajtor dhe se vlerësimet e tyre, më tepër kanë qenë të karakterit të dyshimeve dhe bazohen në veprimet e tyre operative dhe zyrtare, por që nuk gjejnë mbështetje në ndonjë provë tjetër.

Përveç këtyre, fajësia e të pandehurit A. M., nuk mund të vërtetohet as nga deklaramet e të dëmtuarit E. K., dhe dëshmitarit K. K., të cilët kanë dëshmuar, përveç tjerash, se të pandehurin e njohin si person jo problematik dhe nuk kanë dyshuar në të, si kryes i veprës penale për të cilën ishte akuzuar.

Gjithashtu, ndërlidhja e të pandehurit me veprën penale nuk mund të vërtetohet as nga provat tjera materiale që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe në veçanti, as nga Raporti për ekzaminimin e gjurmëve të gishtërinjve ..., datë 15.12.2020, të Teknikës Kriminalistike Regjionale në Mitrovicë në Sistemin ABIS (Sistemi automatik, biometrik i identifikimit të gjurmëve) me numër të data bazës D1-K..., (gjurmë të gishtit

të dorës), nga e cila shihet se “nuk është konfirmuar kandidatë persona të dyshuar lidhur me rastin”.

Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar edhe konstatimet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me video incizimin e kamerës, mirëpo as nga kjo provë nuk rezulton në mënyrë të qartë, bindëse dhe të arsyetuar mjaftueshëm se personi që shihet brenda në lokal, i cili kishte të veshur një jakne ngjyrë të zezë me kapele dhe me maskë në hundë, është në të vërtetë i pandehuri A. M., dhe se konstatimi i gjykatës në fjalë se personit të tillë i shihej vetëm pak pjesa ballore, ku shihet se kishte “pak flokë të zeza në mes, ndërsa anash dukej tullac”, është i pamjaftueshëm për të ardhur deri tek përfundimi i bazuar mirë se ky person ishte në të vërtetë i pandehuri, pa poseduar edhe prova tjera të rëndësishme në lidhje me këtë çështje.

Andaj, bazuar në këto që u theksuan më lart, rezulton se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri A. M., të ketë kryer veprën penale “Vjedhja e rëndë”, nga neni 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPRK-së, për të cilën edhe është akuzuar dhe shpallur fajtor.

Edhe në këtë çështje penale, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që të sqaron se “jo çdo nivel i dyshimit është i mjaftueshëm për të ardhur deri tek përfundimi se i pandehuri është kryes i veprës penale për të cilën akuzohet, por që një gjë e tillë duhet të vërtetohet përtej çdo dyshimi të bazuar mirë”, ndërsa “dyshimi i bazuar mirë” nënkupton posedimin e provave të pranueshme përmes të cilave do të bindej një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri (neni 19, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.12. i KPP-së).

Përndryshe, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen, duhet çdo herë të interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas KPP-së dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (parimi “In Dubio Pro Reo”, neni 3, paragrafi 2 i KPP-së), ndërsa se kur vjen në shprehje zbatimimi i një parimi të tillë, kjo varet nga rrethanat specifike të secili rast veç e veç.

Mbi bazën e këtyre fakteve dhe duke u bazuar në nenin 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që i pandehuri A. M., të lirohet nga akuza, për shkak të veprës penale “Vjedhja e rëndë”, nga neni 315, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPRK-së, të përshkruar më hollësisht në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ngase nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ta ketë kryer këtë vepër penale, për të cilën edhe është shpallur fajtor, siç është cekur më lart.

Meqenëse, i pandehuri A. M. është liruar nga akuza për shkak të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, atëherë Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në nenin 453, paragrafi 1 të KPP-së vendosi që shpenzimet e procedurës penale të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës, kurse palën e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest civil, duke u bazuar në nenin 462, paragrafi 3 të KPP-së.

Në këtë mënyrë, nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

Pml.nr.750/2024, më 12.12.2024

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,  
Agim Maliqi